

## PÉTICION për Këshillin federal dhe për Parlamentin

### «Ndal hipokrizinë!»

Zonja këshilltare federale, Zotrinj këshilltar federal,  
Zonja, Zotrinj përfaqësues të Parlamentit,

Një hipokrizi e madhe politike e përcakton politikën zvicerane për sa i përket të pa dokumentacion : në njërin anë, nevoja për këtë fuqi punëtore për ekonominë dhe në anën tjetër, mohimi zyrtar i të drejtave të tyre themelore. Nënshkruesit e këtij peticioni luftojnë kundër kësaj politike të migrimit !

Në një periudhë afatgjatë, ne kërkojmë që Zvicra ta rishqyrtoj politikën e saj të migrimit e quajtur prej dy rathëve.

Tani për tani, ne kërkojmë me ngul nga Këshilli federal që :

- Të heq dorë nga politika e saj e dëbimeve me forcë dhe çnjerëzore, e panevojshme dhe e kushtueshme ;
- Të heq dorë menjëherë në projektin e saj për ndjekjet e familjeve të pa dokumentacion nëpërmjet denoncimit të fëmijëve të tyre nga institucionet shkollore ;
- Të ruaj mundësinë e tyre për tu shkolluar, në të gjitha nivelet e shkollimit për të gjithë fëmijët pa asnjë diskriminim, duke respektuar Konvetën Ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës ;
- Të vendos pa humbur kohë një mekanizëm për mundësinë e mësimit të një zanati për të rinjtë e padokumentacion, siç është kërkuar nga parlamenti federal në vitin 2010 ;
- Të heq dorë gjithashtu në projektin e saj për të penguar mundësinë e përfitimit të personave të padokumentacion nga sigurimet sociale ;
- Të zbatoj ligjin mbi punën në të zezë në atë mënyrë që të inkurojnë antarsimin e tyre në sigurimetsociale për punëtorët-ret e pa dokumentacion dhe jo si një mjet i denoncimit, në rast nevojë të përmirësohet ligji në këtë drejtim ;
- Të garantoj mundësinë e shfrytësimit të shërbimeve të gjykatave (penale, civile, (prud'homme) gjyq midis padronëve dhe punëtorëve) nga të gjitha ato dhe të gjithë ata pa pasur asnjë rrezik që ata të denoncohen apo të detyrohen që ta lëshojnë vendin në fund të procedurës.

Ne kërkojmë vendosjen e kushteve të cilat mundësojnë rregullimin e personave të cilët qëndrojnë pa statut legal në Zvicër.

	Mbiemri, emri	Adresa	Nënshkrimi
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			

→ Tournez svp

Organizatat dhe partitë politike të cilat e mbështesin këtë peticion

ACLI Ticino | AL Bern | AL Schaffhausen | AL Zürich | Anlaufstelle für Sans-Papiers Basel | Asylbrücke Zug | augen auf Bern | augen auf Zürich | BastA! Basels starke Alternative | Berner Beratungsstelle für Sans-Papiers (VBBS) | Caritas Genève | C.E.D.R.I. | CCSI Fribourg | CCSI Genève | Centre Camarada | Centre Social Protestant Genève | Centre Social Protestant Vaud | cfd - die feministische Friedensorganisation | Collectif de soutien aux sans-papiers de Genève | Collectif Vaudois de Soutien aux Sans-Papiers | Collectifs droit de rester Suisse | Coordination Asile Migration Vaud | CS(A) il Molino | CTSSL - Collectif des travailleuses/eurs sans statut légal | Europäisches BürgerInnen Forum | FIMM Suisse - Forum pour l'intégration des migrantes et des migrants | FIZ Fachstelle Frauenhandel und Frauenmigration | Freiplatzaktion Zürich | Gewählte-Stimme - Stimme der gewählten MigrantInnen für alle | Gioventù Comunista | Giullari di Gulliver | grundrechte.ch | I Verdi Ticino | Interprofessionelle Gewerkschaft IGA | JDS - Juristes démocrates Suisse | Jeunes Verts Suisse | JS Suisse | La Ligue suisse des droits de l'homme/Genève | La Sinistra | l'autre syndicat | Le collectif de soutien et de défense des Sans-Papiers de la Côte | Les Verts | Les Verts Genève | Movimento senza voce | Parti du Travail Genevois | Partito Comunista Ticino | PS Canton Genève | PS Lausanne | PS Suisse | PS Ticino | Red-Latinoamericana Zürich (RLZ) | SIT - Syndicat interprofessionnel de travailleuses et travailleurs | Solidaritaetsnetz Ostschweiz | Solidaritaetsnetz Zürich | Solidarité sans frontières | solidarités | Solinetz Basel | SOS Ticino | SPAZ - Sans-Papiers Anlaufstelle Zürich | Stopexclusion | Syna | Syndical CGAS | Syndicom | terre des hommes suisse | Unia | Union der ArbeiterInnen ohne geregelten Aufenthalt Basel | Unión Mexicana Suiza (UMES) | VPOD Ticino

« Lëvizja zvicerane e të pa dokumentacion – 10 vjet »

### **Kush janë të pa dokumentacion ?**

Të pa dokumentacion janë personat të cilët kanë një identitet dhe një pasaportë, por ata qëndrojnë në Zvicër pa leje qëndrimi. Shumica dërmuese punon, dhe disa prej tyre i paguajnë tatimet e tyre dhe sigurimet sociale. Ata dhe ato po ndërtojnë rrugët dhe shtëpitë tona, po kujdesën për fëmijët tanë, për të smurët dhe personat e moshuar, punojnë në fushat tona, hotele dhe restorane, duke kontribuar gjithashtu edhe në përparimin e këtij vendi. Përkundër kësaj, këta persona jetojnë në frikë të përherëshme se do të denoncohen, zbulohen, arrestohen dhe të dëbohen.

Sipas **parashikimeve shumë mirë të matura, ata dhe ato janë më së paku 100'000 në këtë situatë**. Në mesin e tyre ka gjithashtu edhe azilkërkues. Kështu, me faktin se politika kufizuese e migrimit e Zvicrës, shumë nga personat të cilët kanë qenë në beneficion të një statuti kanë qenë të detyruar që të kalojnë në klandestinitet.

### **Konteksti politik**

Politika migruese e Zvicrës, e themeluar mbi qarkullimin e lirë në gjirin e BE dhe mbylljen thuajse totale ndaj migrantëve të tjerë (politika e dy rrathëve), atëherë kur u pa qartë se këta të fundit po plotësonin një nevojë për Zvicrën. Gjendja aktuale është si rrjedhojë e kësaj politike hipokrite, që me miratimin para pak kohe të ligjit mbit ë huajt, dhe me ashpërsimin e vazhdueshëm e të drejtës së azilit të cilët edhe e kanë zbratur atë nga substanca e vet. Një nga zgjedhjet e vetme e mundëshme për të dal nga klandestiniteti, është rregullimi i ashpër i cili tani është i dominuar në mënyrë arbitrare dhe paraqet një lotari të vërtetë për migrantët të cilët e bëjnë një hap të tillë dhe të rrezikshëm. Sot, më shumë se kurrë shoqëria zvicerane po hynë në një rrugë pa krye në të cilën gjindet, dhe ne nuk ndalemi duke kriminalizuar migrimin dhe duke krijuar kategori të ndryshme të të pa dokumentacion, gjë e cila vetëm se e forcon gjendjen e tyre të vështirë dhe mosbesimin e popullatës ndaj tyre. **Hyrja në fuqi e Ligjit mbi Punën në të Zezë (LTN)** në janar të vitit 2008 është një shembull i përkryer : duke bërë një përzjerje të çuditshme në mes të mos posedimit të lejës së punës dhe mos deklarimit në sigurimet sociale dhe të tatimeve, zbatimi i këtij ligji i dëshpronte punëtorët-ret që të jenë në rregull dhe legjitim, dhe ata përfundimisht dilnin si hileqar-e. Pasojat pra janë përkeqësimi ekstrem i kushteve të punëtorëve-eve dhe dobësimi i sistemit tonë social.

### **10 vite për të dal nga hija**

Që nga fillimi i mobilizimit të të pa dokumentacion në vitin 2001, kjo problematikë gradualisht është imponuar në sytë e publikut dhe të autoriteteve. Sot, askush më nuk e mohon ekzistencën e të pa dokumentacion në Zvicër. Kjo dukshmëri kaq e madhe ka mundësuar përparim në disa lëmi :

- Një mundësi më të mirë në shërbimet shëndetësore ;
- Obligimin që të jetë i-e deklaruar në sigurimet sociale për të gjithë-a ;
- Një mundësi më e mirë dhe e garantuar në shkollimin e obliguar ;
- Mundësinë e mësimi të një zanati në parim.

Këto të drejta është e vertetë se janë me rëndësi por edhe vështirë të zbatueshme, si pasojë e statutit legal. Ato janë gjithashtu të thyeshme, dhe pandërprerë vëhen në sprovë. Kohët e fundit, duke dashur që të forcojnë luftën e tyre kundër imigrimit të pa dëshiruar, Këshilli federal ka parashikuar që të nxjerr familjet e të pa dokumentacion nëpërmjet denoncimit të fëmijëve të tyre nga institucionet shkollore dhe që të pengoj antarësimin e punëtorëve-eve në fjalë në AVS. Kjo mënyrë e ndyrë e të vepruarit ka për qëllim që ti shpiej të pa dokumentacion në klandestinitet, me qëllim që ata-ato të mbeten siç kanë qenë shumë shpesh : një fuqi punëtore e pasigurt, pa të drejta, të lodhur, në mëshirën e dikujt dhe të deportuar në çdo moment.

### **Cfarë të ardhme ?**

Nuk do të ju pëlqej disave, por ne nuk mund të ndalemi vetëm se te migrimet. Dështimi i të gjitha politikave të migrimit në këto deceniet e fundit në Zvicër, të cilat nuk kanë bërë asgjë tjetër vetëm se kanë krijuar klandestin dhe pasiguri, duket haptazi. Bëhet fjalë tani që të njihet ky realitet dhe se duhet ndryshuar dhe të kalojmë këtë vështirësi, është në interesin e migrantëve-eve, por gjithashtu edhe në atë të tërë shoqërisë tonë. Është po aq urgjente që të gjinden zgjidhjet pragmatike se një gjeneratë e tretë e të pa dokumentacion – e integruar dhe e shkolluar në Zvicër – është duke lindur.

[Ju lutemi që ti dërgoni peticionet e nënshkruara më së largu deri më 15 shtator 2011 në këtë adresë :](#)

**Solidarité sans frontières | Neuengasse 8 | 3011 Berne**

Organizatat dhe partitë politike të cilat e mbështesin këtë peticion

ACLI Ticino | AL Bern | AL Schaffhausen | AL Zürich | Anlaufstelle für Sans-Papiers Basel | Asylbrücke Zug | augenauf Bern | augenauf Zürich | BastA! Basels starke Alternative | Berner Beratungsstelle für Sans-Papiers (VBBS) | Caritas Genève | C.E.D.R.I. | CCSI Fribourg | CCSI Genève | Centre Camarada | Centre Social Protestant Genève | Centre Social Protestant Vaud | cfd - die feministische Friedensorganisation | Collectif de soutien aux sans-papiers de Genève | Collectif Vaudois de Soutien aux Sans-Papiers | Collectifs droit de rester Suisse | Coordination Asile Migration Vaud | CS(A il Molino | CTSSL - Collectif des travailleuses/eurs sans statut légal | Europäisches BürgerInnen Forum | FIMM Suisse - Forum pour l'intégration des migrantes et des migrants | FIZ Fachstelle Frauenhandel und Frauenmigration | Freiplatzaktion Zürich | Gewählte-Stimme - Stimme der gewählten MigrantInnen für alle | Gioventù Comunista | Giullari di Gulliver | grundrechte.ch | I Verdi Ticino | Interprofessionelle Gewerkschaft IGA | JDS - Juristes démocrates Suisse | Jeunes Verts Suisse | JS Suisse | La Ligue suisse des droits de l'homme/Genève | La Sinistra | l'autre syndicat | Le collectif de soutien et de défense des Sans-Papiers de la Côte | Les Verts | Les Verts Genève | Movimento senza voce | Parti du Travail Genevois | Partito Comunista Ticino | PS Canton Genève | PS Lausanne | PS Suisse | PS Ticino | Red-Latinoamericana Zürich (RLZ) | SIT - Syndicat interprofessionnel de travailleuses et travailleurs | Solidaritaetsnetz Ostschweiz | Solidaritaetsnetz Zürich | Solidarité sans frontières | solidaritÉS | Solinetz Basel | SOS Ticino | SPAZ - Sans-Papiers Anlaufstelle Zürich | Stopexclusion | Syna | Syndical CGAS | Syndicom | terre des hommes suisse | Unia | Union der ArbeiterInnen ohne geregelten Aufenthalt Basel | Unión Mexicana Suiza (UMES) | VPOD Ticino